
THE RIGHTS OF THE DEFENDANT IN CRIMINAL PROCEDURE

Havsa MusliuSaints Cyril and Methodius University of Skopje, Republic of Macedonia havsamusliu@gmail.com

Abstract: This paper contains the following segments: theoretical explanations for the defendant's rights in criminal proceedings, the purposes of the defendant's rights, the role of courts, public prosecutors and police and their obligation to respect the rules of the Criminal Code and Criminal Procedure Law and the rights provided by these acts. Furthermore, in general we will talk about the defendant's rights, which are these and how respected are those rights in Republic of Macedonia. A person charged with a criminal offense has the right to a fair and public trial, within a reasonable time, before a competent, independent and impartial court established by law and in particular we will talk about the presumption of innocence, the right to silence in criminal proceedings and how these rights are respected in our legislation, the right to be informed in a timely manner and in a detailed language, in a language that he understands, of the deeds for which he is charged and of the evidence against him; not be forced to give a statement against himself or his relatives or to admit guilt; to be informed that he has the right to an attorney and if he cannot afford an attorney, one will be appointed for him.

Keywords: courts, judges, efficiency, reasonable time, corruption, politics.

TË DREJTAT E TË PANDEHURIT NË PROCEDURË PENALE**Havsa Musliu, PhD student**

Universiteti Shën Kirili dhe Metodij në Shkup, Republika e Maqedonisë

havsamusliu@gmail.com

Abstrakt: Ky punim përmban këto segmente: shpjegime teorike për të drejtat e të pandehurit në procedurën penale, qëllimet e të drejtave të të pandehurit, rolin e gjykatave, prokurorët public dhe policinë dhe obligimin e tyre për respektimin e rregullave të Kodit Penal dhe Ligjit të Procedurës Penale dhe të drejtat e parashikuara nga këto akte. Në përgjithësi do të flasim për të drejtat e të pandehurve, cilat janë këto dhe sa respektohen këto të drejta në Republikën e Maqedonisë. Personi i akuzuar për një vepër penale ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik, brenda një kohe të arsyeshme, përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme të themeluar me ligj dhe në veçanti do të flasim për prezumimin e pafajësisë, procedurat penale dhe sa respektohen këto të drejtanë legjislativon tonë, të drejtën për t'u informuar në kohë dhe në gjuhë që ai kupton, për veprat për të cilat ai është akuzuar dhe për provat kundër tij; të mos jetë i detyruar të japë deklaratë kundër vetes ose të afërmeve të tij ose të pranojë fajin; të informohet se ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmën e mbrojtësit. Kur nuk ka mjete të mjaftueshme I sigurohet mbrojtja falas me avokat.

Fjalët kyçe: gjykatat, gjyqtarët, efikasiteti, koha e arsyeshme, korrupsioni, politika.

Të gjithë njerëzit janë të barabartë përpara ligjit dhe kanë të drejtë mbrojtjeje të barabartë të ligjit pa kurrfarë dallimi. Lidhur me këtë, ligji duhet të ndalojë çdo diskriminim dhe të garantojë për të gjithë, mbrojtje të barabartë dhe efektive, kundër çdo diskriminimi e sidomos për shkak të racës, ngjyrës, seksit, gjuhës, fesë, opinionit politik dhe çdo opinionit tjetër, origjinës kombëtare apo shoqërore, pasurisë, lindjes ose çdo shtetë tjetër³⁹¹.

Edhe të pandehurit si subjekt në procedurë penale, me Dokumente Ndërkombëtare, me Kushtetutë dhe me Ligj i janë garantuar shumë të drejta. I pandehuri është subjekt dhe palë në procedurë penale prej momentit të fillimit të saj dhe në pajtim me këtë ka edhe të drejta të shumta. Ndër të drejtat më të rëndësishme të të pandehurit në procedurë penale do të shqyrtojmë:

Personi i akuzuar për vepër penale ka të drejtë në gjykim të drejtë dhe publik, në afat të arsyeshëm, para një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme, të themeluar me ligj³⁹². Për veprimet më të rëndësishme

³⁹¹ Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike. Miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 2200 A (XXI), 16 dhjetor 1966, hyri në fuqi 23 mars 1976, neni 26.

³⁹² Ligji për procedurë penale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.15, 07.03.2005, Tekst i spastruar, neni 4 parag. 1.

procedurale të gjykatës dhe prokurorit publik Ligji për procedurë penale parasheh afate përkatëse me kushte me të cilët duhet të sigurohet mirëmbajtja e procedurës³⁹³.

Edhe pse kundër të pandehurit është ngritur ndjekje penale, personi i akuzuar për vepër penale do të konsiderohet i pafajshëm përderisa faji i tij të vërtetohet me aktgjykim të formës së prerë. Kjo rrjedh nga parimi i prezumimit të pafajësisë të të pandehurit e cila është e paraparë me Kushtetutë dhe me Ligjin për procedurë penale të Republikës së Maqedonisë³⁹⁴, përkatësisht të pandehurit i jepet e drejta që të trajtohet si person kundër të cilit ekziston dyshim i bazuar se ka kryer vepër penale, por për të cilin ende nuk është vërtetuar nëse në të vertetë është fajtorë. Pasojë e mëtejshme e këtij parimi është se paditësi i autorizuar është i detyruar ta provojë fajin e të pandehurit, e jo e kundërta i pandehuri ta provojë pafajësinë e tij: parimi se barra e provave shtrihet mbi paditësin³⁹⁵.

Në lidhje të ngushtë me prezumimin e pafajësisë qëndron edhe ndalimi dhe ndëshkimi i detyrimit të të pandehurit që të pohoj fajësinë dhe dhënien e deklaratave tjera³⁹⁶. Me këtë ndalim është e lidhur edhe ndalimi i aplikimit të çfarëdo lloji force³⁹⁷, kërcënimi, si dhe ndalimi i aplikimit të intervenimeve ose mjeteve mjekësore me të cilat do të ndikoheshin në vullnetin e të pandehurit gjatë dhënies së deklaramit³⁹⁸.

I pandehuri duhet të njoftohet për aktakuzën, që don të thotë se i pandehuri duhet të informohet me të gjitha faktet të cilat e rëndojnë, që të mund të mbrohet, pra kemi të bëjmë me parimin kontradiktor dhe barazisë së armëve³⁹⁹.

I pandehuri ka të garantuar të drejtën e heshtjes: parimi i zgjedhjes së lirë të mënyrës së mbrojtjes (i pandehuri mund të mbrohet në mënyrë aktive ose me heshtje)⁴⁰⁰, por para kësaj i pandehuri duhet të paralajmërohet që me heshtjen e privon gjykatën që prej tij t'i kuptojë ato rrethana të cilat do t'i shkonin në favor, përkatësisht që do t'i shërbenin për mbrojtjen e tij⁴⁰¹. Prej marrjes në pyetje për herë të parë do të njoftohet për çka akuzohet dhe do t'i komunikohen bazat e dyshimit që qëndrojnë kundër tij dhe do të pyetet çka do të deklaroj në mbrojtjen e tij, por do të njoftohet se nuk është i obliguar të deklaroj në mbrojtjen e tij e as t'u përgjigjet pyetjeve të parashtruara⁴⁰², përkatësisht në shqyrtim kryesor kryetari i këshillit do ta paralajmëroj të pandehurin për të drejtën e heshtjes⁴⁰³, dhe, nëse i pandehuri e përdor këtë të drejtë të tij, nuk duhet t'i merret si rrethanë rënduese gjatë caktimit të dënimit, përkatësisht nuk duhet të ketë asnjë pasojë negative për të pandehurin. Me fjalë tjera heshtja e të pandehurit nuk paraqet asnjë provë në procedurë, e as në bazë të saj nuk mund të nxjerin përfundime në dëm të të pandehurit. I pandehuri që ka refuzuar të përgjigjet mundet gjatë procesit të deklarorë, ndërsa deklarimin e dhënë më parë apo pranimin e fajësisë në çdo kohë mund ta ndryshoj ose ta revokoj. Kjo, si dhe e drejta paraprake e të pandehurit, gjën

³⁹³ Сулејманов, Зоран, Кривично процесно право, Скопје, 2002, fq. 171.

³⁹⁴ Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë (teksti jozyrtarë, i spastruar – për përdorim intern), Universiteti i Evropës Juglindore (UEJL), përktheu, përshtati dhe redaktoi Kurtesh Saliu, Tetovë, 2007, neni 13 parag. 1 dhe Ligji për procedurë penale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.15, 07.03.2005, Tekst i spastruar, neni 2 parag. 1.

³⁹⁵ Матовски, Никола, Казнено процесно право-Општ дел, Скопје, 2003, fq. 202.

³⁹⁶ Ligji për procedurë penale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.15, 07.03.2005, Tekst i spastruar, neni 3 parag. 1.

³⁹⁷ Ligji për procedurë penale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.15, 07.03.2005, Tekst i spastruar, neni 231 parag. 1.

³⁹⁸ Ligji për procedurë penale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.15, 07.03.2005, Tekst i spastruar, neni 273 parag. 2.

³⁹⁹ Konventa Evropjane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore – 4 nëntor 1950. E miratuar më 4 nëntor 1959 në Romë. Konventa ka hyrë në fuqi më 3 shtator 1953, neni 5 parag. 2 dhe neni 6 parag. 3; Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike. Miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 2200 A (XXI), 16 dhjetor 1966, hyri në fuqi 23 mars 1976. Neni 9 parag. 2 dhe neni 14 parag. 3; Ligji për procedurë penale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.15, 07.03.2005, Tekst i spastruar, neni 3 parag. 1.

⁴⁰⁰ Матовски, Никола, Казнено процесно право-Општ дел, Скопје, 2003, fq. 202.

⁴⁰¹ Пић, Милајло, priredila Mr. Hajrija Sijerčić- Čolić, Krivično procesno право, Sarajevo, 1997, fq. 104.


⁴⁰² Ligji për procedurë penale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.15, 07.03.2005, Tekst i spastruar, neni 230 parag. 2.

⁴⁰³ Ligji për procedurë penale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.15, 07.03.2005, Tekst i spastruar, neni 334 parag. 4.

bazen në maksimum latinisht *nemo contra se edere tenetur* – askush nuk është i detyruar të jap prova kundër vetes, çka do të thotë se i pandehuri nuk mund të detyrohet në rrëfim apo deklaratë⁴⁰⁴.

Secili i pandehur për një veprë penale ka të drejtë plotësisht të barabartë të ketë këto garanci minimale:

Figura 2 - Garancitë minimale të të pandehurit



Burimi: 2⁴⁰⁵; 3⁴⁰⁶; 4⁴⁰⁷; 7⁴⁰⁸; 8⁴⁰⁹; 9⁴¹⁰.

⁴⁰⁴ Сулејманов, Зоран, Кривично процесно право, Скопје, 2002, fq. 172;

⁴⁰⁵ Ligji për procedurë penale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 150, 18. 11. 2010., neni 70.

⁴⁰⁶ Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore – 4 nëntor 1950. E miratuar më 4 nëntor 1959 në Romë. Konventa ka hyrë në fuqi më 3 shtator 1953. Neni. 6 parag. 3; Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike. Miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 2200 A (XXI), 16 dhjetor 1966, hyri në fuqi 23 mars 1976. Neni 14 parag. 3; Ligji për procedurë penale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.15, 07.03.2005. Tekst i spastruar, neni 4 parag. 2.

⁴⁰⁷ Derti, Mevlut, Mbrojtja e të miturve të cilëve u është hequr liria,, Të dhëna nga interneti: <http://www.mevlut.publiku.com>. zbritur më: 08.09.2010.

⁴⁰⁸ Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore – 4 nëntor 1950. E miratuar më 4 nëntor 1959 në Romë. Konventa ka hyrë në fuqi më 3 shtator 1953. Neni 6 parag. 3; Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike. Miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 2200 A (XXI), 16 dhjetor 1966, hyri në fuqi 23 mars 1976. Neni 14 parag. 3; Ligji për procedurë penale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.15, 07.03.2005, Tekst i spastruar, neni 4 parag. 2.

I pandehuri ka mundësi të gjëra procedurale për pozitë aktive në procedurë, sidomos për propozim të provave të cilat gjykata i sjell në shqyrtim kryesor. Ai ka edhe të drejtë në ankesë kundër të gjitha vendimeve të marra gjatë procedurës penale⁴¹¹.

Dobi të mëtejshëm që Ligji për procedurë penale i jep të pandehurit qëndron në atë se atij i jepet fjala përfundimtare në shqyrtimin kryesorë. Në atë mënyrë paraqitet mundësia që gjykata të mbetet nën përshtypjen e fjalës përfundimtare të paditësit.

Në mes shumë institucioneve të cilat kanë të bëjnë me pozitën e të pandehurit në procedurë penale kuptim të veçantë ka instituti *reformatio in peius*⁴¹² (*ndalimi i përmirësimit në dëm (të të pandehurit)*), përmbajtja e së cilës përbëhet prej asaj që, nëse është paraqitur ankesë vetëm në favor të të pandehurit, aktgjykimi nuk mund të ndryshohet në dëm të tij sa i përket vlerësimit ligjor të veprës penale dhe sanksionit penal⁴¹³. Kështu që, i pandehuri me ankesën e tij në asnjë mënyrë nuk mund ta dëmtoj veten, dhe kjo i mundëson që të drejtën e tij në ankesë ta shfrytëzojë pa frikë dhe në masë të plotë⁴¹⁴.

Në dobi të të pandehurit është paraparë edhe institucioni *beneficium cohaesionis*⁴¹⁵ që konsiston në detyrimin e gjykatës së lartë – gjykatës së shkallës së dytë, kur me rastin e ankesës së dikujt, sjell vendim me të cilën e përmirëson aktgjykimin e shkallës së parë në favor të njërit prej më shumë personave të akuzuar, favori i tillë vlen edhe për të akuzuarit tjerë, pavarësisht se ato nuk kanë paraqitur ankesë, natyrisht nëse shkaqet e përmirësimit shkojnë në dobi të tyre⁴¹⁶.

Gjithashtu kjo vlen edhe për vendimet në lidhje me kundërshtimin e aktakuzës, si dhe për vendimet në lidhje me rregullin për mbrojtjen e ligjshmërisë. Në idenë e drejtësisë dhe humanitetit bazohet edhe rregulli sipas të cilës në rast se me mjetet ligjore të jashtëzakonshme kërkohet përsëritja e procedurës penale, të mos lejohet përsëritja e procedurës penale në dëm të të dënuarit ose të liruarit nëse kanë kaluar më shumë se gjashtë muaj prej ditës kur prokurori ka marrë në dijeni për fakte ose prova të reja. Këtë masë të jashtëzakonshme mund ta përdorë edhe vet i pandehuri, edhe atë pa marrë parasysh afatet. Në lidhje me këtë është i rëndësishëm edhe rregulli që njëherit procesi i pushuar kundër të pandehurit mund të vazhdohet vetëm nëse paraqesin prova të reja, pra, nën kushtet e përsëritjes së procedurës, për të cilën vendos gjykata. Me këtë është përjashtuar mundësia që procesi penal kundër të pandehurit njëherit i pushuar lehtë të ri-hapet dhe kështu i pandehuri të mbahet në pezullim⁴¹⁷.

Dobia e veçantë për të pandehurin qëndron në atë se ekzistojnë mjete ligjore të jashtëzakonshme, vetëm në dobi të tij, e këto janë zbutja e jashtëzakonshme e dënimit⁴¹⁸ dhe shqyrtimi i jashtëzakonshëm i aktgjykimit të plotëfuqishëm⁴¹⁹ si dhe kompenzim të dëmit të të dënuarit pa arsye ose të të privuarit pa bazë nga liria⁴²⁰.

Krahas asaj që të pandehurit i jepet pozita e palës përkatësisht subjektit procedural me të drejta të caktuara në procedurën penale, Ligji për procedurë penale i jep të pandehurit disa të drejta tjera të veçanta dhe nëpërmjet shumë dispozitave të tij e shpreh qëndrimin human kundrejt të pandehurit. Grupi i të gjitha këtyre të drejtave procedurale që shkojnë në favor të të pandehurit dhe si garancion i subjektivitetit të tij procedural i quajmë favor defensionis – dobi të mbrojtjes. Kështu që, masat preventive të privimit të lirisë (paraburgimi) jo vetëm që janë të lidhura saktësisht me kushte të caktuara ligjore, por në mënyrë më të veçantë është caktuar se ato do të zgjasin vetëm aq sa është absolutisht e domosdoshme. Gjatë kohës së vuajtjeve të këtyre masave i pandehuri ka dobi të konsiderueshme dhe këto masa jepen vetëm në atë vëllim që është i nevojshëm për arritjen e qëllimit të tyre. Të gjitha kufizimet tjera,

⁴⁰⁹ Ligji për procedurë penale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 150, 18. 11. 2010., neni 70.

⁴¹⁰ Ibid.

⁴¹¹ Сулејманов, Зоран, Кривично процесно право, Скопје; 2002, fq. 173.

⁴¹² Ligji për procedurë penale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.15, 07.03.2005, Tekst i spastruar, neni 395.

⁴¹³ Матовски, Никола, Казнено процесно право-Општ дел, Скопје, 2003, fq. 203.

⁴¹⁴ Пић, Мihaјло, priredila Mr. Hajrija Sijerčić- Čolić, Krivično procesno pravo, Sarajevo, 1997, fq. 105.

⁴¹⁵ Ligji për procedurë penale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.15, 07.03.2005, Tekst i spastruar, neni 397.

⁴¹⁶ Матовски, Никола, Казнено процесно право-Општ дел, Скопје, 2003, fq. 203.

⁴¹⁷ Пић, Мihaјло, priredila Mr. Hajrija Sijerčić- Čolić, Krivično procesno pravo, Sarajevo, 1997, fq. 105-106.

⁴¹⁸ Sipas Ligjit për procedurë penale të Republikës së Maqedonisë, “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 150/2010, kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit si mjet i jashtëzakonshëm juridik nuk parashihet;

⁴¹⁹ Пић, Мihaјло, priredila Mr. Hajrija Sijerčić- Čolić; Krivično procesno pravo, Sarajevo, 1997, fq. 106.

⁴²⁰ Матовски, Никола, Казнено процесно право-Општ дел, Скопје, 2003, fq. 203.

të cilat nuk kontribuojnë në arritjen e qëllimeve të këtyre masave, normat procedurale nuk i njohin, dhe për këtë arsye edhe nuk i lejojnë⁴²¹.

Shteti juridik në të cilin do të mbrohen të drejtat e njeriut kërkon institucione të fuqishme, kompetente dhe stabile që do të kenë kapacitet që ti zbatojnë ligjet. Mirëpo, fatkeqësisht realiteti i gjyqësisë tonë nuk është i tillë.

Edhe pse qëllim kryesor është forcimi i pavarësisë dhe mëvetësisë së gjyqësisë, eliminimin e ndikesës së politikës, fatkeqësisht në shtetin tonë me kalimin e kohës gjithnjë e më tepër janë të dukshëm elementët sipas të cilave, përkundër deklarimeve, politika ditore bën përpjekje që pikërisht reformat në gjyqësi t'i shfrytëzojë si vegël për ndikesë politike.

Përballë pranimi të paradigmave bashkëkohore të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut dhe sundimit të të drejtës, sistemi gjyqësor në Republikën e Maqedonisë gjendet në gjendje të krizës permanente e cila pasqyrohet në stërzgjatjen dhe mos efikasitetin e procedurave gjyqësore dhe artikulon një mungesë të përgjithshme të besimit në gjyqësinë, që rezulton me erozion të dukshëm të vlerave të rendit juridik në përgjithësi.

Nga raportet e Komitetit të Helsinkit, raportet e Komitetit për Parandalimin e Torturës së Këshillit të Evropës, vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe më shumë organizata tjera relevante qeveritare dhe joqeveritare shihet se autoritetet vendase nuk janë kujdesur në mënyrë të mjaftueshme që ti mënjanojnë burimet e lëndimeve serioze të të drejtave të njeriut. Domethënë nuk janë siguruar mekanizmat mbrojtës nga keqpërdorimet policore të cilat sot në përgjithësi janë përkrahur në Evropë dhe Komiteti për Parandalimin e Torturës: informimi i familjes, të mësuarit për të drejtat, drejta për mbrojtës, mjek, procedurat për veprimin me të dyshuarit dhe ngjashëm. Qëllimi i këtyre standardeve dhe procedurave fuqimisht të vendosura është që të veprohet në mënyrë parandaluese dhe për minimizimin e tejkalimeve policore të autorizimeve.

Kushtet për mbajtje janë nën nivelin që siguron trajtim dinjitos dhe human. Komiteti i Helsinkit konsideron se përcaktimi i të gjitha 38 stacioneve më të mëdha policore si vend për mbajtje, duke mos u pajisur të njëjtat për kënaqjen e standardeve policore evropiane për mbrojtjen e të drejtave të personave të mbajtur në stacion policor dhe të privuar nga liria janë joserioze dhe mu për këtë përjeton kritika nga Komiteti për Parandalimin e Torturës. Në realitet e njëjta është lajthitje e thjeshtë e obligimit ligjor nga Ligji për procedurë penale të vitit 2004, e për implementimin e plotë të të cilës Komiteti i Helsinkit insiston tanimë një kohë më të gjatë⁴²².

Nga ana tjetër, në fushën e reagimit efikas dhe efektiv për incidentet serioze me hetime që do të jenë të shpejta, me themel dhe të tërësishme, gjë e cila nga ana e vet poashtu do të ndikojë në mënyrë parandaluese në tejkalimet dhe keqpërdorimet e autorizimeve policore nuk është bërë pothuajse asgjë edhe pse për këtë vite me radhë tërheq vërejtjen Komiteti për Parandalimin e Torturës në rekomandimet për Republikën e Maqedonisë, e poashtu edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në disa vendime gjyqësore (Jashar, Sulejmanov dhe ngjashëm). Në raportet e Komitetit për Parandalimin e Torturës dhe në literaturën relevante Republika e Maqedonisë sot për fat të keq theksohet si shembull i keq i shtetit në të cilin ekziston praktikë e rrënjosur thellë dhe gjerë e përhapur e mos ndëshkimit (impunity) të personave zyrtar të cilët i kanë tejkaluar autorizimet.

Kështu, integriteti i sistemit të përgjegjësisë të personave zyrtar në rastet ku ekzistojnë konstatime për keqpërdorime në Republikën e Maqedonisë ishte në fokusin e vëmendjes së Komitetit për Parandalimin e Torturës - dhe burim i tij më i madh i brengosjes – që në vizitën në tetor të vitit 2001. Në kontrollimet në çdo vizitë të ardhshme të delegacioneve të Komitetit për Parandalimin e Torturës gjithmonë përsëritej se edhe në rastet kur personat e mbajtur në polici do të ankoheshin para prokurorit publik ose para gjykatësit hetues se kanë qenë të torturuar, nuk ekzistojnë garanci se për rastin do të zbatohet hetim efikas. Mu për këtë Komiteti në disa raste dha rekomandime të qarta për luftën me këtë gjendje brengosëse i ftoi autoritetet vendase që të njëjtat ti implementojë në praktikë. Gjendjet e këtilla, e posaçërisht injorimi këmbëngulës i rekomandimeve të Komitetit për Parandalimin e Torturës, sollën deri te ajo që Republikës së Maqedonisë ti dërgohet vërejtje serioze në kuadër të Këshillit të Evropës⁴²³.

Komiteti i Helsinkit i përkrah ndryshimet e propozuara nga ekspertët vendas dhe të OSBE-së për mënyrë të re dhe efikase të hetimeve dhe tejkalimeve policore të autorizimeve me themelimin e një seksioni të ri në prokurorinë publike, i cili do të kishte kompetencë ekskluzive që t'i përndjek kryerësit e veprave penale të cilët janë persona zyrtar në organe të caktuara represive dhe do të kishte mundësi për orientim më të madh të policisë, kështu që


⁴²¹ Ilić, Mihajlo, priredila Mr. Hajrija Sijerčić- Čolić, Krivično procesno pravo, Sarajevo, 1997, fq. 104-105.

⁴²² Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut i Republikës së Maqedonisë, Raporti vjetor 2008, Të dhëna nga internet: <http://www.mhc.org.mk/WBStorage/Files/Annual%20report%202008%20Alb.pdf>. Zbritur më: 05.09.2011.

⁴²³ Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut i Republikës së Maqedonisë, Raporti vjetor 2008, Të dhëna nga internet: <http://www.mhc.org.mk/WBStorage/Files/Annual%20report%202008%20Alb.pdf>. zbritur më: 05.09.2011.

shkeljet e të drejtave dhe lirive të individëve nga ana e personave zyrtarë dhe nga ana e organeve represive të ndiqen (të bëhet përndjekje) në masë më të madhe dhe në mënyrë më efikase⁴²⁴.

Në vijim do të paraqesim llojet e shkeljeve të konstatuara me aktgjykimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Republikës së Maqedonisë në periudhën e viteve 2008 – 2009.



Burimi: Република Македонија Министерство за правда владин агент на Република Македонија информација за состојбата на предмети против Република Македонија пред Европскиот суд за човекови права за 2008 година, Скопје, Април 2009, Тë dhëna nga interneti:

<http://www.pravda.gov.mk/documents/godisen%20izvestaj%202008.pdf>; <http://www.pravda.gov.mk/documents/godisen%202009%20usvoen%20za%20objava.pdf>.

LITERATURA E SHFRYTËZUAR

1. Derti, Mevlut, Mbrojtja e të miturve të cilëve u është hequr liria,, Të dhëna nga interneti: <http://www.mevlut.publiku.com>. zbritur më: 08.09.2010.
2. Ilić, Mihajlo, priredila Mr. Hajrija Sijerčić- Čolić, Krivično procesno pravo, Sarajevo, 1997.
3. Konventa Evropjane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore – 4 nëntor 1950. E miratuar më 4 nëntor 1959 në Romë. Konventa ka hyrë në fuqi më 3 shtator 1953.
4. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë (teksti jozyrtarë, i spastruar – për përdorim intern), Universiteti i Evropës Juglindore (UEJL), përktheu, përshtati dhe redaktoi Kurtesh Saliu, Tetovë, 2007.
5. Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut i Republikës së Maqedonisë, Raporti vjetor 2008, Të dhëna nga internet: <http://www.mhc.org.mk/WBStorage/Files/Annual%20report%202008%20Alb.pdf>. Zbritur më: 05.09.2011.
6. Ligji për procedurë penale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.15, 07.03.2005, Tekst i spastruar.
7. Ligji për procedurë penale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 150, 18. 11. 2010.
8. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike. Miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 2200 A (XXI), 16 dhjetor 1966, hyri në fuqi 23 mars 1976.

⁴²⁴ Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut i Republikës së Maqedonisë, Raporti vjetor 2008, Të dhëna nga interneti:

<http://www.mhc.org.mk/WBStorage/Files/Annual%20report%202008%20Alb.pdf>. Zbritur më: 05.09.2011.

9. Матовски, Никола, Казнено процесно право-Општ дел, Скопје, 2003.
10. Република Македонија Министерство за правда владин агент на Република Македонија информација за состојбата на предмети против Република Македонија пред Европскиот суд за човекови права за 2008 година, Скопје, Април 2009, Тë dhëna nga interneti:
<http://www.pravda.gov.mk/documents/godisen%20izvestaj%202008.pdf>;
<http://www.pravda.gov.mk/documents/godisen%202009%20usvoen%20za%20objava.pdf>.
11. Сулејманов, Зоран, Кривично процесно право, Скопје, 2002.